

V E N D I M
Nr.267, datë 24.4.2003

**PËR PROCEDURAT E PROPOZIMIT DHE SHPALLJEN E ZONAVE TË MBROJTURA
DHE BUFERIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për propozimin dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Mjedisit përgatit planin e shpalljes së zonave të mbrojtura, ku përcaktohen zonat që synohen të shpallen të tilla, statusi, kufijtë dhe shkalla e mbrojtjes së secilës prej tyre.

b) Plani hartohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, me organet e qeverisjes vendore, me institutet kërkimore-shkencore përkatëse dhe me shoqatat mjedisore.

c) Çdo organ e institucion shtetëror, qendror ose vendor, person juridik ose fizik, shoqatë jofitimprurëse ose komunitet, ka të drejtë të paraqesë në Ministrinë e Mjedisit propozime për shpalljen e zonave të mbrojtura, për ndryshimin ose heqjen e statusit të çdo zone të mbrojtur, për zgjerimin ose zvogëlimin e kufijve të zonës dhe për zonimin e brendshëm të tyre.

ç) Për shpalljen e zonave të mbrojtura merret parasysh rrjeti i zonave të mbrojtura, i paraqitur në strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin.

d) Në publikimin e planit të zonave të mbrojtura jepet edhe afati njëmuor, brenda të cilit mund të bëhen vërejtje e sugjerime, të cilat paraqiten në Ministrinë e Mjedisit.

dh) Me kalimin e këtij afati dhe, nëse nuk ka pasur vërejtje e kundërshtime, plani quhet i vlefshëm dhe në bazë të tij, Ministria e Mjedisit fillon procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen e projektvendimit për shpalljen e zonave të mbrojtura.

2. Për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohen, paraprakisht, statusi i saj, kufijtë dhe zonimi i brendshëm, zona buferike rreth saj, administrata e ruajtjes së zonës dhe varësia e saj, mundësitë e përpunimit e të shfrytëzimit të zonës, të ardhurat që mund të krijohen dhe përdorimi i tyre në dobi të zonës, në bazë të studimeve rajonale.

3. Ministria e Mjedisit jep njoftime publike për zonat e mbrojtura, të miratuara, për monumentet natyrore, për drurët e mbrojtur, për llojet e bimëve dhe të kafshëve veçanërisht të mbrojtura, për gjetjet minerare dhe paleontologjike, duke përcaktuar me hollësi kushtet për mbrojtjen e tyre.

4. Për zonat e mbrojtura, të shpallura përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, merr masat për përshtatjen e statusit të tyre, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano